



PJESA A: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 3 pikë

1. Figura në vijim tregon 3 shigjeta fluturuese dhe 9 balona. Kur shigjeta e godet një balonë e shkatërron atë dhe shigjeta vazhdon të fluturojë në të njëjtin drejtim. Sa balona nuk do të goditen nga shigjetat?








(A) 3	(B) 2	(C) 6	(D) 5	(E) 4
-------	-------	-------	-------	-------


2. Tri objekte gjenden në tavolinë.



Çfarë sheh Petriti nëse shikon në tavolinë nga sipër?


(A) 	(B) 	(C) 	(D) 	(E) 
---	---	---	--	---

3. Herën e parë Diana arriti gjithsejtë 14 pikë me dy shigjeta. Herën e dytë ajo arriti 16 pikë. Sa pikë arriti ajo në herën e tretë?



(A) 17	(B) 18	(C) 19	(D) 20	(E) 22
--------	--------	--------	--------	--------

4. Një kopsht ndahet në katrorë të njëjtë. Një kërmill i shpejt dhe një kërmill i ngadalshëm lëvizin përgjatë perimetrit të kopshtit duke u nisur nga skaji S, e duke lëvizur në drejtime të ndryshme. Kërmilli i ngadalshëm lëviz me shpejtësi 1 metër në orë (1 m/h) kurse kërmilli i shpejt 2 metra në orë (2 m/h). Në cilën pikë do të takohen të dy kërmijtë?




- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

5. Rrezja zbriti dy numra 2 shifror. Ajo pastaj ngjyrosi dy qelula. Sa është shuma e shifrave në qelulat e ngjyrosura?

$$\begin{array}{|c|c|c|c|} \hline & 3 & - & 2 \\ \hline \hline & 2 & & 5 \\ \hline \end{array} = 25$$


- (A) 8 (B) 9 (C) 12 (D) 13 (E) 15

6. Një yll është ndërtuar nga katër trekëndësha barabrinjës dhe një katror. Perimetri i katrorit është 36 cm. Sa është perimetri i yllit?



- (A) 144 cm (B) 120 cm (C) 104 cm (D) 90 cm (E) 72 cm

7. Figura vijuese tregon kalendarin e njërit muaj. Fatkeqësisht ngjyra i mbuloi shumicën e datave. Cila ditë është i 25-ti i atij muaji?




- (A) E hënë (B) E mërkurë (C) E enjte (D) E shtunë (E) E dielë

8. Sa herë duhet të hedhim një zarë të zakonshëm për t'u siguruar që së paku njëri rezultat do të përsëritet?


- | | | | | |
|-------|-------|-------|--------|--------|
| (A) 5 | (B) 6 | (C) 7 | (D) 12 | (E) 18 |
|-------|-------|-------|--------|--------|

9. Në figurë janë 3 katrorë. Gjatësia e brinjës së katrorit më të vogël është 6 cm. Sa është gjatësia e brinjës së katrorit më të madh?



- | | | | | |
|-------|--------|--------|--------|--------|
| (A) 8 | (B) 10 | (C) 12 | (D) 14 | (E) 16 |
|-------|--------|--------|--------|--------|

10. Në figurën vijuese, rrathët paraqesin llamba të lidhura me disa llamba të tjera.




Në fillim të gjitha llambat janë të çkyqura. Kur e prekni njëren llambë të gjitha llambat fqinje ndriçohen dhe llamba që keni prekur po ashtu ndriçohet . Sa llamba të paktën duhet të prekni për t'i ndriçuar të gjitha llambat?

- | | | | | |
|-------|-------|-------|-------|-------|
| (A) 2 | (B) 3 | (C) 4 | (D) 5 | (E) 6 |
|-------|-------|-------|-------|-------|


PJESA B: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 4 pikë

11. Në cilin nga katër katrorët raporti i pjesës së zezë ndaj pjesës së bardhë është më i madhi?




- | | | | | |
|-------|-------|-------|-------|------------------------------|
| (A) A | (B) B | (C) C | (D) D | (E) të gjithë janë të njëjtë |
|-------|-------|-------|-------|------------------------------|


12. Nëntë vetura gjenden në udhëkryq dhe lëvizin siç tregojnë shigjetat.



Cila figurë i tregon veturat pasi të gjitha e kalojnë udhëkryqin?



13. Secila prej figurave mbulon njërin nga numrat 1, 2, 3, 4 ose 5 në mënyrë që njehsimet pas shigjetave janë të sakta. Cila numër mbulohet nga figura me ylli?



- | | | | | |
|-------|-------|-------|-------|-------|
| (A) 1 | (B) 2 | (C) 3 | (D) 4 | (E) 5 |
|-------|-------|-------|-------|-------|

14. Një luan gjendet pas njëres nga tri dyert. Në secilën derë shënon një fjali por vetëm njëra nga tri fjalitë është e saktë. Në cilën derë gjendet luani?




- | | | | | |
|-------------|-------------|-------------|-----------------------------------|---|
| (A) Derën 1 | (B) Derën 2 | (C) Derën 3 | (D) Të tri dyert janë të mundshme | (E) Të dy dyert: 1 dhe 2 janë të mundshme |
|-------------|-------------|-------------|-----------------------------------|---|

15. Dy vajza, Hana dhe Lulja dhe tre djem Arti, Gëzimi dhe Urani luajnë me top. Kur ndonjëra vajzë ka topin, ajo e hedh atë te ndonjë vajzë tjetër apo te ndonjë djalë. Kur ndonjëri djalë ka topin ai e hedh atë te ndonjë djalë tjetër, por jo te djali prej të cilit e ka pranuar topin. Hana filloi duke i dërguar topin Artit. Kush do të bëjë hedhjen e pestë?

- | | | | | |
|----------|----------|------------|-----------|-----------|
| (A) Arti | (B) Hana | (C) Gëzimi | (D) Lulja | (E) Urani |
|----------|----------|------------|-----------|-----------|

16. Era dëshiron të shënojë një numër në secilën qelulë të tabelës trekëndore. Shuma e numrave në çdo qelulë me brinjë të përbashkët duhet të jetë e njëjtë. Ajo tashmë ka shënuar dy numra. Sa është shuma e të gjithë numrave në tabelë?




- | | | | | |
|--------|--------|--------|--------|-------------------------------|
| (A) 18 | (B) 20 | (C) 21 | (D) 22 | (E) e pamundur të përcaktohet |
|--------|--------|--------|--------|-------------------------------|

17. Të hënën, Merita e ndanë një fotografi me 5 shokët e saj. Për disa ditë, secili person që pranon fotografinë, e dërgon atë të nesërmen te dy shokë që ende nuk e kanë parë fotografinë. Në cilën ditë numri i personave që kanë parë fotografinë bëhet më i madh se 100?

- | | | | | |
|-----------------|---------------|----------------|----------------|---------------|
| (A) Të mërkurën | (B) Të enjten | (C) Të premten | (D) Të shtunën | (E) Të dielën |
|-----------------|---------------|----------------|----------------|---------------|

18. Faqet e një kubi janë ngjyrosur me ngjyrë të zezë, të bardhë ose të hirtë, ashtu që faqet përballë njëra-tjetrës janë me ngjyra të ndryshme. Cili nga rastet vijuese nuk mund të jetë kubi i shpalosur?





19. Luani bëri disa njehsime me shkronjat A, B, C dhe D . Cila shifër përfaqësohet nga shkronja B ?

$$\begin{array}{r}
 ABC \\
 + \\
 CBA \\
 \hline
 DDD
 \end{array}$$

- | | | | | |
|-------|-------|-------|-------|-------|
| (A) 0 | (B) 2 | (C) 4 | (D) 5 | (E) 6 |
|-------|-------|-------|-------|-------|

20. Katër mollëkuqe qëndrojnë në qelula të ndryshme të rrjetës 4×4 . Njëra prej tyre është duke fjetur dhe nuk lëviz. Çdo herë që fishkëlloni, 3 mollëkuqet tjera lëvizin në një qelulë të lirë fqinje. Ato mund të lëvizin: lart, poshtë, djathtas ose majtas por nuk lejohen të kthehen në qelulën prej nga kanë ardhur. Cila nga figurat vijuese mund të paraqet situatën pas fishkëllimës së katërt?




PJESA C: Çdo përgjigje e saktë vlerësohet me 5 pikë

21. Nga lista 3, 5, 2, 6, 1, 4, 7, Sara zgjodhi 3 numra të ndryshëm shuma e të cilëve është 8. Nga e njëjta listë, Edlira zgjodhi 3 numra të ndryshëm shuma e të cilëve është 7. Sa numra të përbashkët janë zgjedhur nga të dy vajzat?

(A) asnjë	(B) 1	(C) 2	(D) 3	(E) e pamundur të përcaktohet
-----------	-------	-------	-------	-------------------------------

22. Pesë topa peshojnë 30 g, 50 g, 50 g, 50 g dhe 80 g, përkatësisht.



Cili top peshon 30 g?

(A) A	(B) B	(C) C	(D) D	(E) E
-------	-------	-------	-------	-------

23. Nëse A, B, C janë shifra të ndryshme, atëherë numri më i madh i mundshëm 6 shifrorë që shënohet duke përdorur 3 shifra A, 2 shifra B dhe një shifër C nuk mund të jetë i barabartë me

(A) AAABBC	(B) CAAABB	(C) BBAAAC	(D) AAABCB	(E) AAACBB
------------	------------	------------	------------	------------


24. Shuma e moshave të Anitës dhe nënës së saj është 36, dhe shuma e moshave të nënës së saj dhe gjyshes së saj është 81. Sa vite kishte gjyshja kur u lind Anita?

(A) 28	(B) 38	(C) 45	(D) 53	(E) 56
--------	--------	--------	--------	--------

25. Kreshniku dëshiron të ndaj numrat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 në disa grupe, ashtu që shuma e numrave në secilin grup të jetë e njëjtë. Sa është numri më i madh i grupeve që ai mund të formojë?


(A) 2	(B) 3	(C) 4	(D) 6	(E) ndonjë përgjigje tjetër
-------	-------	-------	-------	-----------------------------

26. Fatlumi pa një shportë druri të gjerë 8 cm të ndarë në 9 pjesë. Njëra pjesë ishte katror, të tjerat drejtkëndësha. Ai pastaj i bashkoi pjesët siç tregohet në figurë. Sa ishte e gjatë shporta?



(A) 150 cm	(B) 168 cm	(C) 196 cm	(D) 200 cm	(E) 232 cm
------------	------------	------------	------------	------------

27. Shënoni numrat 0 ose 1 në secilën qelulë të tabelës 5x5 ashtu që secili katror 2x2 i tabelës 5x5 të përmbajë saktësisht tre numra të njëjtë. Sa është shuma më e madhe e mundshme e të gjithë numrave në tabelë?



(A) 22


(B) 21

(C) 20

(D) 19

(E) 18

28. 14 persona janë të ulur në një tavolinë të rrumbullakët. Secili person ose është gënjeshtar ose e thotë të vërtetën.



Të dy fqinjët e mi janë gënjeshtarë

Secili thotë: "Që të dy fqinjët e mi janë gënjeshtar ". Sa është numri maksimal i gënjeshtarëve në tabelë?

(A) 7


(B) 8

(C) 9


(D) 10

(E) 14

29. Në tabelë janë tetë pllaka të dominos. Gjysma e njëres pllakë është e mbuluar. 8 pllakat duhet të vendosen në katrorin 4 x 4 (figura 2) ashtu që numri i pikave në secilin rresht dhe në secilën



shtyllë të jetë i njëjtë. Sa pika gjenden në pjesën e mbuluar?



(A) 1


(B) 2

(C) 3

(D) 4

(E) 5

30. Në 7 rrathët shënoni numrat 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 që të fitoni shumë të njëjtë përgjatë të tri vijave. Sa është shuma e të gjithë numrave të mundshëm që zëvendësojnë pikëpyetjen?



(A) 3

(B) 6

(C) 9

(D) 12

(E) 18

Gara Math Kangaroo – Kosovë
Klasat 5-6

